



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas

Zyra e Kryetarit

01 Nr. 400-35727 më 09.07.2015

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Nexhat Dema

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën: 25.06.2015

- 1 .Korniza afatmesme buxhetore komunale 2016-2018
2. Vendimi për mbështetje financiare për projektin K.F "Feronikeli"



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 400-35195 dt 8.07 2015

Në bazë të nenit 12 pika d, nenit 40 pika b, dhe c, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b. dhe c. Të Statutit të Komunës së Drenasit, rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve si dhe vendimit për buxhet të aprovuar për vitin 2015 Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 25.06.2015 aprovoi këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim aprovet kërkesa për mbështetje financiare për projektin e K.F., „Feronikeli” lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin vjeshtor 2015, anëtar i superligës së Kosovës.

Neni 2.

Projekti i K.F., „Feronikeli” përkrahet me shumën prej 40.000€ mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2015.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/200.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e KF., „Feronikeli”. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KF „Feronikeli” që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DRKS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Kryetari i Kuvendit të Komunës
Naim Bazaj